

FJALA E DEPUTETES MIRELA PITUSHI

E ENJTE 12 MAJ 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Pak kohë më parë në Kuvend kemi diskutuar për luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe kundër intimidimit të grave në politikë. Në një tryezë tjetër në Kuvend kemi diskutuar dhe miratuar konventën për eliminimin e dhunës dhe ngacmimin në botën e punës “Bashkë me ILO-n kundër dhunës”, që u organizua për rritjen e nivelit të përfaqësjes së legjislacionit vendas me standardet e ILO-s dhe ato të Bashkimit Europian në raport me dhunën, ngacmimin dhe diskriminimin me bazë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësimit. U ndala te këto dy aktivitete me objekt pozicionin e gruas në jetën e përditshme, pasi sa më i lartë të jetë niveli i barazisë gjinore, aq më të larta janë vlerat e qenësishme të shoqërisë sonë demokratike.

Tashmë jemi të ndërgjegjshëm se, përmes investimeve në drejtim të rritjes së barazisë gjinore, kemi ndryshime të rëndësishme në jetën e përditshme të grave dhe vajzave në punësim dhe në pagesë. Investimi te barazia gjinore çon jo vetëm në përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave, por edhe në transformimin pozitiv të mënyrës së të jetuarit të burrave dhe djemve, prandaj vëmendja duhet të përqendrohet në rritjen e kujdesit për krijimin dhe zgjerimin e hapësirës për të promovuar barazinë gjinore, sepse kështu do të arrijmë ta bëjmë komunitetin ku jetojmë dhe të gjithë shoqërinë më të fortë dhe më të pasur, duke bërë që në afate të gjata të përfitojnë të gjithë. Sot më shumë se kurrë duhet të këmbëngulim që të arrijmë një hov cilësor në drejtim të barazisë gjinore, por nuk duhet të fokusohemi vetëm te perspektiva, e ardhmja e grave dhe e vajzave, por edhe te djemtë dhe burrat, si pjesë përbërëse e qelizës familjare.

Shpesh mund të jetë e vështirë për të parë relevancën e perspektivës gjinore, si mjet për arritjen e barazisë gjinore në programe të ndryshme, veçanërisht ato teknike dhe shkencore. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të shikojmë efektin që ka çdo veprim te burrat dhe gratë, sepse është e qenësishme të kuptojmë dimensionin gjinor të këtyre proceseve, politikave dhe programeve për të adresuar çështje të ndryshme të barazisë gjinore. Duke vlerësuar implikimin për gratë dhe burrat në çdo veprim të planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat dhe programet në të gjitha fushat e nivelet, ne

mund t'i bëjmë shqetësimet, përvojat dhe nevojat e grave e burrave dimensione integrale të politikave dhe programeve në sferën politike, ekonomike dhe sociale. Kështu ne arrijmë të sigurohemi që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë.

Gjithashtu, dihet që përfshirja e perspektivës gjinore në fusha të ndryshme të zhvillimit siguron jo vetëm të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale për gratë dhe burrat, por siguron edhe arritje efektive të qëllimeve të tjera sociale dhe ekonomike. Pra, duke punuar drejt barazisë gjinore ne mund të sfidojmë rolet gjinore tradicionale, rrjedhimisht jo vetëm që ndihmojmë krijimin e mundësive të barabarta për të dyja gjinitë, por edhe përmirësimin e marrëdhënieve mes burrave dhe grave. Për më tepër, rolet gjinore, që nuk janë të bazuar në stereotipe gjinore, krijojnë gamë të gjerë mundësish për burrat dhe gratë, sepse, siç dihet, në një vend si ky yni ndarja gjinore është ende një karakteristikë e fortë edhe në tregun e punës, gjë që pastaj pasqyrohet edhe në arsim dhe në edukim, duke i limituar të dyja gjinitë në mundësitë dhe zgjedhjet e tyre.

Të sfiduarit e stereotipeve për rolet gjinore dhe krijimi i mundësive të barabarta në punësim si për burrat, ashtu dhe për gratë do të na ndihmonte që dalëngadalë të bëhet zhvendosja e rolit tradicional, ku burri shihet si shtylla e familjes, i cili pritet t'ia kushtojë jetën e tij punës për të siguruar mirëqenie në familje. Gjithashtu, kjo do t'i lironte ndjeshëm burrat nga barra kryesore e vendimmarrjes, duke ua lehtësuar përgjegjësitë, sepse një mentalitet i bazuar në stereotipe gjinore vetëm skllavëron gratë dhe burrat. Krijimi i mundësive të barabarta për të dyja gjinitë ndikon pozitivisht si në aspektet ekonomike, ashtu dhe në ato sociale dhe politike, sepse në çdo vend është e pamundur të arrihet ndonjë ndryshim domethënës nëse nuk shfrytëzohet potenciali i burrave dhe i grave. Tani më shumë se kurrë kemi nevojë për ndryshime pozitive domethënëse, prandaj duhet të krijohen mundësitë të barabarta për burrat dhe gratë.

Të nderuar kolegë,

Përpara se të flas për politikën huamarrëse dhe strategjinë e veprimit për procedurat e arritjes së marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për një hua të bazuar në politikat për mbështetjen e barazisë gjinore, në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri, më lejoni të shpreh kënaqësinë time për mbështetjen që i jep qeveria shqiptare përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet, politike e shoqërore me nisma konkrete, më e fundit është kjo, nëpërmjet një mbështetje buxhetore, pra një hua prej 50 milionë eurosh për të mbështetur palët e interesuara shqiptare në zbatimin e veprimeve ambicioze të politikave, për të nxitur

barazinë gjinore në aksesin për mundësitë ekonomike në mbështetje të gruas dhe kauzës së saj, si dhe për të përmirësuar kuadrin ligjor për akses të barabartë gjinor. Financimi i planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondi i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimi kryesor.

Reformat e ndërmarra në kuadër të barazisë gjinore, në akses ndaj mundësive ekonomike, janë parakushte për akordimin e kësaj mbështetje buxhetore, e cila shkon për të mundësuar nevojat për financim të buxhetit të shtetit. Pra, mbulimi i nevojave për financim, nëpërmjet mbështetjes buxhetore, është një ndër instrumentet më të favorshme të financimit. Meqenëse kemi të bëjmë me kredi me terma të buta dhe të akorduar nga institucione ndërkombëtare zhvillimi si: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane për Zhvillim, Agjencia Franceze për Zhvillim, si dhe vetë Bashkimi Europian, këto institucione mbështesin zhvillimin e vendeve të ndryshme, ndër të cilat është edhe vendi ynë, financimi i akorduar nga këta partnerë të rëndësishëm jo vetëm që jepet me terma më të favorshëm se kushtet e tregut, por mundëson suport për realizimin e reformave të ndryshme dhe të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Programi i qeverisë e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës si për meshkujt, ashtu edhe për gratë, në përputhje me vizionin e direktivave të Bashkimit Europian, Strategjinë Europiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesat për integrimin europian të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Procedura për miratimin e marrëveshjes është iniciuar që në vitin 2020 me vendimin nr. 1129, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave dhe nënshkrimi i saj është bërë nga palët në datën 25.11.2021. Pra, referenca e vendimit të Këshillit të Ministrave është bërë në programin e qeverisë 2017 – 2021. Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, me vendimin nr. 400, datë 30.06.2021, kjo marrëveshje lidhet me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Pikërisht objektivi 5, objektivi 8 dhe objektivi i 10-të. Objektivi i 5-të është barazia gjinore, arritja e barazisë gjinore në forcim të të gjithë grave dhe vajzave. Objektivi i 8-të është puna dinjitoze dhe rritja ekonomike; nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë. Objektivi i 10 është zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve.

Propozimi i kësaj huamarrje është mbështetur në objektivat e programit të mëparshëm të qeverisë për të përmirësuar kuadrin e politikave dhe të legjisllacionit për akses të barabartë gjinor, si dhe përfshirjen e këtyre objektiveve edhe në programin e ri të qeverisjes 2021 – 2025. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 -2022 identifikon politikat e duhura nxitëse në vend dhe punësimin me formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijohen vende pune dhe mundësi cilësore për punësim

dhe aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës për të gjithë gratë dhe burrat shqiptarë. Me qëllim mbikëqyrjen e progresit të projektit dhe orientimin për zbatimin e reformave, në kuadër të barazisë gjinore, është krijuar komiteti drejtues i projektit, i cili përfshin përfaqësues nga të gjitha institucionet partnere.

Të nderuar kolegë,

T'i japim forcë dhe mbështetje kauzës së barazisë gjinore, duke e miratuar këtë marrëveshje, si një hap pozitiv në vazhdimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore. Faleminderit!